



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Këshilli Gjyqësor i Kosovës
Sudski Savet Kosova - Kosovo Judicial Council



PLANI STRATEGJIK

2023-2025

MESAZH NGA KRYESUESI I KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS

Në emër të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) dhe të gjithë gjyqësorit të Kosovës, kam kënaqësinë të prezantoj para qytetarëve të Kosovës këtë Plan Strategjik të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për 2023–2025. Ky Plan Strategjik paraqet produktin e një studimi disa mujor, gjatë të cilit kolegët e KGJK-së, Sekretariati dhe gjyqësori në Kosovë kanë bashkëpunuar në rishikimin e planeve tona strategjike të kaluara dhe aktuale, si dhe **përvojën funksionale të gjyqësorit** gjatë disa viteve të fundit.

Ky Plan për periudhën 2023–2025 pasqyron synimin tonë për t'u bazuar mbi sukseset tona, si dhe për t'u fokusuar në fushat që kanë nevojë për përmirësim. Rezultati është një udhërrëfyes për gjyqësorin, i cili do të udhëzojë punën dhe aktivitetet e gjyqësorit gjatë tre viteve të ardhshme. Plani vendos një kornizë për të rritur besimin e publikut në gjyqësor, me fokus në **përforcimin e shërbimeve, qasshmërisë dhe llogaridhënies**.

Plani ynë për të ardhmen është largpamës, i përqendruar te njerëzit dhe ka për qëllim të përdorë plotësisht teknologjinë në mbështetjen dhe përsheptimin e funksionimit dhe administrimit të gjykatave. Me këtë Plan Strategjik, që përshkruan rrugën tonë drejt së ardhmes, do të zhvillohemi mbi të kaluarën, me synimin që të vazhdojmë **ndërtimin e një themeli të qëndrueshëm** për të përballuar sfidat tona aktuale dhe të ardhshme.

ALBERT ZOGAJ

KRYESUES

Këshilli Gjyqësor i Kosovës

HYRJE

Hartimi i këtij Plani Strategjik për tre vitet e ardhshme ka qenë proces i vazhdueshëm i afirmimit dhe përfshirjes së vlerave thelbësore të mirëpërcaktuara dhe të njohura ndërkombëtarisht, e të domosdoshme për një **gjyqësor dinamik në një shoqëri demokratike**.

Kushtetuta e Republikës sonë i garanton secilit person të drejtat e barazisë, lirisë dhe drejtësisë. Këto të drejta qenësore për demokracinë, mbrohen me **respektim të vazhdueshëm për sundimin e ligjit**, ndërsa gjykatat duhet të shërbejnë si mbrojtëse të këtyre të drejtave të çmuara.

Përmes këtij dokumenti, gjyqësori i Kosovës shpreh **angazhimin dhe përkushtimin** ndaj këtyre vlerave thelbësore si parime tonat udhëzuese:



SUNDIMI I LIGJIT

Të respektohen parimet e vendosura, duke siguruar stabilitet, qëndrueshmëri dhe shpjegime të mirë-arsyetuar të vendimeve.



DREJTËSI E BARABARTË

Dinjiteti i natyrshëm i çdo personi që meriton trajtim të barabartë dhe të drejtë sipas ligjit.



PAVARËSI

Gjyqësor i lirë nga politika, për zbatimin objektiv, të barabartë dhe të drejtë të kushtetutës dhe ligjeve. Duke e kuptuar gjyqësorin si pushtet i pavarur i Republikës së Kosovës. Duke ushtruar përgjegjësitë e veta pa frikë e pa favorizime.



LLOGARIDHËNIE

Respektim i standardeve etike të sjelljes së mirëfilltë gjyqësore dhe shfrytëzimit të përgjegjshëm të fondeve dhe mjeteve publike.



PËRSOSMËRI

Përkushtim ndaj sigurimit të drejtësisë me kujdes, në mënyrë të drejtë dhe të barabartë me respektim të rreptë të sundimit të së drejtës.



SHËRBIM

T'i shërbehet jo vetëm Republikës dhe Kushtetutës dhe ligjeve të saj, por t'i shërbehet të gjithë qytetarëve të Kosovës në mënyrën më efikase dhe më të drejtë, duke i qëndruar besnikë standardeve më të larta të cilësisë dhe kompetencës. Ky është thelbi i "Drejtësisë së Përqendruar tek Njerëzit" që gjyqësori i Kosovës ka dedikim ta respektojë.

KGJK e kupton se detyrimi i ofrimit të një sistemi cilësor të drejtësisë për qytetarët e Kosovës nuk është pa sfida. Detyra jonë është e vështirë, por KGJK është e përkushtuar për të përballuar këto sfida. Ne e kuptojmë dhe vlerësojmë rolin qendror të gjyqësorit si **institucion i pavarur** në ndërtimin dhe mbrojtjen e lirive dhe demokracisë sonë. Ne e kuptojmë se duhet të jemi kreativë dhe të zellshëm në shërbim të njerëzve dhe në përmbushjen e qëllimeve, si dhe objektivave tona.

Gjyqësori është **gurthemel i Republikës sonë**. Për këtë qëllim, ky Plan Strategjik është hartuar përmes një procesi bashkëpunues që kërkon të dhëna nga një sërë burimesh. Kemi organizuar këtë Plan në pesë qëllime kyçe, që identifikojnë çështjet më madhore të cilat duhen adresuar.

Secili qëllim frymëzohet dhe bazohet mbi **vlerat qenësore** të përmendura më lart. Këto pesë qëllime mbizotëruese janë:

- 1** Gjyqësor i pavarur, efikas dhe transparent
- 2** Cilësia, llogaridhënia dhe profesionalizmi i gjyqësorit
- 3** Qasja në drejtësi
- 4** Ndërtimi i besimit të publikut
- 5** Teknologjia në mbështetje të funksionimit dhe qasjes në gjykata

Gjatë hartimit të këtij Plani Strategjik 2023–2025, u bë e qartë se secili qëllim ndërthuret dhe në një farë mase ka efekt e ndikim në secilin nga qëllimet tjera. Secili qëllim dhe aktivitetet e tij mbështet dhe përforcon të tjerët.

Qëllimet janë të ndërlidhura dhe në një masë, janë të ndërvarura. KGJK është e bindur se duke punuar së bashku në përcjelljen dhe arritjen e këtyre qëllimeve, do të vazhdoj të ndërtoj themelet e forta gjyqësore që qytetarët e Kosovës e meritojnë. Pjesa e parë e këtij plani paraqet pesë qëllimet, ku secili pasohet nga objektiva strategjike që e përforcojnë atë qëllim të caktuar.

Pjesa e dytë e këtij Plani Strategjik përmban **Planin Vjetor të Punës për vitin 2023**, i cili përcakton ato iniciativa dhe aktivitete specifike për të mbështetur dhe arritur qëllimet strategjike.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës së fundmi ka hartuar e miratuar disa plane specifike, siç janë: **“Plani Strategjik për Qasje në Drjetësi 2022–2025”** (Plani Strategjik për Efikasitet dhe Prioritizim të lëndëve) dhe **“Strategjia e Komunikimit të KGJK-së 2022–2024”** (Strategjia e Komunikimit).

Këtij Plani Strategjik i janë aneksuar disa plane shtesë të punës, të cilat janë miratuar nga KGJK së bashku me Planin Strategjik të KGJK-së për 2023–2025 dhe Planin Vjetor të Punës për vitin 2023. Këto plane shtesë janë: të gjitha planet e punës së Komisioneve të KGJK-së, planet e punës së zyrëve, departamenteve dhe njësive të Sekretariatit si dhe plani i punës së Njesisë së Inspektimit Gjyqësor.

Qëllimi i këtij Plani Strategjik 2023–2025 është të përfshijë dhe mbështesë zbatimin e suksesshëm të këtyre strategjive më specifike dhe të mbështesë rekomandimet, iniciativat dhe veprimet e përcaktuara nga këto strategji në afatet e duhura kohore.

Ne jemi gjithashtu të përkushtuar për të arritur dhe adaptuar standardet dhe rekomandimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim–Asociimit me Bashkimin Evropian, nën-komitetet relevante përfshirë Nën-komitetin për Lirinë e Drejtësisë dhe Sigurisë, Agjenda e Reformës Evropiane dhe standardet e përcaktuara në rekomandimet e Këshillit të Evropës.

Zbatimi i këtyre aktiviteteve kërkon resurse e përkushtim. Për këtë qëllim, ne do të angazhohemi me partnerët tanë ndërkombëtarë, të cilët kanë shprehur interesimin e tyre të vazhdueshëm për të mbështetur përpjekjet tona për të avancuar sistemin tonë të drejtësisë. Ne e çmojmë mbështetjen e tyre të vazhdueshme në përforcimin e sistemit tonë të drejtësisë dhe në arritjen e atyre standardeve të njohura ndërkombëtarisht të cilat i aspirojmë.

KGJK ka nderin t'i prezantojë qytetarëve të Kosovës këtë Plan Strategjik 2023-2025. Përmes këtij Plani, KGJK- dhe gjyqësori në tërësi janë të përkushtuar t'i shërbejnë qytetarëve.

Përpjekjet tona të përshkruara me këtë Plan do të na shtyjnë përpara që t'i ofrojmë qytetarëve të Kosovës **një sistem gjyqësor të pavarur dhe të përqendruar te njerëzit**, i cili mishëron vlerat thelbësore të përcaktuara më lartë.





MISIONI

ZHVILLIMI DHE VAZHDIMËSIA E NJË GJYQËSORI TË PAVARUR,
QË OFRON SHËRBIME GJYQËSORE TË PAANSHME PËR TË
GJITHË, SI DHE ËSHTË FUNKSIONAL NË TË GJITHA ASPEKTET
ORGANIZATIVE DHE OPERACIONALE

VIZIONI

SISTEM GJYQËSOR QË ËSHTË I PAVARUR, I QASSHËM PËR TË
GJITHË, I DREJTË, EFIKAS NË PUNËN E TIJ, I PËRGJEGJSHËM PËR
PUNËN E TIJ, FUNKSIONAL ME STANDARDET MË TË LARTA TË
NDERSHMËRISË, KOMPETENCAVE, PROFESIONALIZMIT E
TRANSPARENCËS

QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

1

QËLLIMI 1: GJYQËSOR I PAVARUR, EFIKAS DHE TRANSPARENT

Një sistem gjyqësor funksional i ofron qytetarëve të Kosovës sistem të organizuar, efektiv dhe efikas që është i fokusuar tek të shërbyerit për të gjithë që kanë nevojë të drejtohen në gjykatat për të zgjidhur kontestet dhe për të ndarë drejtësinë në kohën e duhur në përputhje me Kushtetutën, ligjet e Kosovës, si dhe pritshmëritë e përgjithshme të publikut. Tre elementët përshkruese të paraqitura në këtë qëllim janë thelbësore për arritjen e gjyqësorit që është i besueshëm dhe funksional. Palët në të gjitha çështjet që dalin para gjykatave duhet të trajtohen me dinjitet dhe respekt, ndërsa vendimet e dhëna duhet të respektohen dhe zbatohen.

Gjyqësori duhet të perceptohet si sistem objektiv dhe i pavarur, i lirë nga ndikimi politik. Procedurat duhet të jenë të qarta, koncize dhe lehtësisht të kuptueshme dhe të zbatueshme. Pa këto, besimi i publikut në sistemin gjyqësor nuk mund të arrihet. Për më tepër, gjyqësori i fuqishëm e i besuar është thelbësor për ndërtimin e një ekonomie të fuqishme e të domosdoshme për një demokraci që lulëzon. Duhet të arrihet menaxhimi efektiv i burimeve financiare dhe njerëzore në dispozicion, si dhe për aq sa është e mundur, gjyqësori duhet të mbështetet në burimet, përvojën dhe njohuritë e partnerëve tanë ndërkombëtarë.

Siç përmendet tek Qëllimi 5, teknologjia aktuale në dispozicion duhet të përdoret plotësisht për të harmonizuar e lehtësuar menaxhimin dhe procedurat e gjykatës. Qëllimi 1 është baza mbi të cilën zhvillohen katër Qëllimet e tjera në këtë Plan Strategjik.

OBJEKTIVAT STRATEGJIKE:

1.1 Promovimi i konceptit të Sistemit Gjyqësor si institucion i pavarur kushtetues, dhe si degë e pushtetit e barabartë me të tjerat, e që ka në qendër qytetarët dhe e përkushtuar për t'i shërbyer të gjithë qytetarëve të Kosovës në mënyrë të drejtë si dhe në konsistencë dhe përputhje me Kushtetutën si dhe ligjet e Republikës.

1.2 Të përforcohet struktura dhe funksionet institucionale të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, për të përmbushur sa më mirë nevojat e sistemit gjyqësor dhe për t'iu përshtatur rrethanave që ndryshojnë.

1.3 Të sigurohen burimet adekuate financiare përmes procedurave buxhetore të Kuvendit të Republikës së Kosovës, si dhe të sigurohet mbështetja nga partnerët ndërkombëtarë.

1.4 Të rregullohet ndarja e burimeve njerëzore dhe materiale sipas nevojës, për të siguruar efikasitet maksimal, ky aktivitet të përshtatet në frymën e përdorimit më të madh të teknologjisë në mbështetje të funksioneve të gjykatës.

1.5 Të përmirësohet komunikimi i brendshëm mes KGJK-së dhe gjykatave në gjithë Kosovën, siç është përcaktuar në Strategjinë e Komunikimit.

1.6 Të rritet roli i Komisionit për Administrimin e Gjykatave dhe Kryetarëve të gjykatave për të monitoruar zbatimin e Planit Strategjik dhe Planit Vjetor të Punës.

1.7 Të kërkohet procedim me kohë i rasteve dhe të arrihet implementimi i plotë i praktikave të menaxhimit të rasteve, siç parashihet me Planin Strategjik për Qasje në Drejtësi, të përmendur më sipër.

1.8 Të promovohen mënyrat alternative për procedurat gjyqësore.

1.9 Të rritet raportimi dhe shpalosja para publikut e informatave përkatëse për veprimtarinë e gjyqësorit.

1.10 Publikimi në kohë i vendimeve gjyqësore, aktvendimeve dhe aktgjykimeve.

1.11 Monitorimi i pajtueshmërisë së Objektivave Strategjike të këtij Plani Strategjik me aktivitetet e parapara me Planet Vjetore të Punës dhe dokumentet tjera strategjike.

2

QËLLIMI 2: CILËSIA, LLOGARIDHËNIA DHE PROFESIONALIZMI I GJYQËSORIT

Qëllimi 2 është i lidhur ngushtë me Qëllimin 1 të përmendur më lartë. Të dy Qëllimet janë qenësore për njëri-tjetrin. Elementet kryesore të këtij Qëllimi janë një kombinim i rekrutimit efektiv, verifikimit, trajnimit, monitorimit të kontrollit të cilësisë, llogaridhënies dhe disiplinës. Vëmendja e posaçme ndaj rekrutimit efektiv dhe me kohë të personelit gjyqësor, profesional dhe administrativ të KGJK-së, si dhe mbarë gjyqësorit, është e domosdoshme për të pasur sistem drejtësie të përgjegjshëm dhe konsistent. Trajnimi i vazhdueshëm dhe i përhershëm i gjithë personelit gjyqësor është i nevojshëm për të plotësuar nevojat e palëve të gjykatave si dhe për të promovuar konceptin e një sistemi drejtësie "të përqendruar te njerëzit". Standardet e performancës, shumë prej të cilave njihen nga komuniteti ndërkombëtar, duhet të vlerësohen vazhdimisht, të përshtaten për të përmbushur nevojat lokale, të zbatohen dhe monitorohen. Gjithashtu, duhet të merren iniciativa për përsosmëri dhe rolet e monitorimit dhe disiplinës duhet të njihen si elemente thelbësore të funksionimit cilësor profesional dhe administrativ.

Bashkëpunimi i vazhdueshëm me Akademinë e Drejtësisë së Kosovës duhet të ndodhë për të përmbushur nevojat e personelit gjyqësor dhe administrativ dhe për të ofruar produkte pune të nivelit më të lartë të cilësisë dhe kompetencës.

OBJEKTIVAT STRATEGJIKE:

2.1 Përkushtimi institucional për t'i shërbyer qytetarëve të Kosovës me fokus "të përqendruar te njerëzit" të shërbimit cilësor, integritetit dhe përkushtimit ndaj drejtësisë dhe barazisë.

2.2 Shqyrtimi dhe zhvillimi i vazhdueshëm i mundësive relevante specifike të trajnimit për personelin gjyqësor dhe administrativ, në koordinim të ngushtë me Akademinë e Drejtësisë së Kosovës dhe partnerët tanë ndërkombëtarë. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet trajnimit të etikës dhe menaxhimit për personelin përkatës të gjykatës.

2.3 Zhvillimi i mundësive për karrierë, si për personelin gjyqësor ashtu edhe për atë administrativ.

2.4 Konsistencë më e madhe në vendime dhe arsyetime në mbështetje të aktvendimeve dhe aktgjykimeve.

2.5 Shqyrtimi i standardeve të vlerësimit të performancës dhe rishikimi sipas nevojës.

2.6 Shqyrtimi dhe përforcimi i mekanizmave të kontrollit dhe monitorimit të cilësisë për të gjithë stafin gjyqësor dhe administrativ. Legjislacioni dhe rregulloret në këtë drejtim duhet të përcjellen dhe të vendosen sipas nevojës.

2.7 Përmirësimi dhe forcimi i proceseve të brendshme disiplinore, si për personelin gjyqësor ashtu edhe për atë administrativ, me legjislacionin dhe rregulloret e duhura sipas nevojës.

3

QËLLIMI 3: QASJA NË DREJTËSI

Një sistem drejtësie me “qytetarët në qendër” i jep prioritet ofrimit të shërbimeve gjyqësore të përshtatshme, të sigurta, të rregullta dhe cilësore për publikun. KGJK është e përkushtuar të sigurojë qasje në drejtësi për të gjithë qytetarët e Kosovës, pa marrë parasysh statusin ekonomik, përkatësinë etnike, moshën, gjininë apo karakteristikat tjera personale. Arritja e këtij Qëllimi të Qasjes në Drejtësi do të çojë pashmangshëm drejt arritjes së Qëllimit 4 (Besimi Publik). Gjykatat dhe shërbimet e gjykatave duhet të jenë të pëlqyeshme dhe miqësore për përdoruesit. “Qasja në drejtësi” duhet të kuptohet të përfshijë si qasjen fizike ashtu edhe qasjen procedurale.

Ky Qëllim nënkupton që të gjithë personat duhet të kenë qasje fizike në gjykata. Gjykatat duhet të ofrojnë hapësira të sigurta e të rregullta për publikun, si dhe për të gjithë stafin e gjykatës, për të kryer punët e nevojshme. Qasja procedurale përfshin procese të qarta dhe të thjeshta që reduktojnë vonesat dhe ulin edhe shpenzimet për palët gjyqësore. Gjyqësori i Kosovës duhet gjithashtu të mbështesë dhe inkurajojë ofrimin e shërbimeve juridike për ata që nuk janë në gjendje të sigurojnë përfaqësues ligjorë, qoftë në procedura civile apo penale.

OBJEKTIVAT STRATEGJIKE:

3.1 Përafrimi dhe angazhimi me publikun, siç parashikohet në Strategjinë e Komunikimit të përmendur më lartë.

3.2 Sigurimi i objekteve të reja dhe renovimeve sipas rastit, për të promovuar e lehtësuar qasjen e publikut në objektet e gjykatave.

3.3 Sigurimi i qasjes fizike dhe akomodimit për palët në gjykata që kanë aftësi të kufizuara.

3.4 Sigurimi i hapësirave të përshtatshme, të sigurta e të rregullta për të gjithë stafin e gjykatës dhe publikun.

3.5 Përmirësimi i qasjes në drejtësi, me fokus në uljen e vonesave, uljen e kostove dhe thjeshtimin e procedurave.

3.6 Eliminimi i barrierave gjuhësore, duke ofruar përkthim dhe interpretim cilësor sipas nevojës.

3.7 Zhvillimi i qasjes virtuale, në rastet e përshtatshme.

3.8 Lehtësimi dhe mbështetja e programeve që ofrojnë qasje për personat të cilët janë përfitues të ndihmës sociale gjatë procedurave gjyqësore.

4 QËLLIMI 4: **BESIMI DHE KËNAQSHMËRIA E PUBLIKUT**

Besimi dhe kënaqshmëria me sistemin gjyqësor fitohet duke ofruar zgjidhje të drejtë dhe të rregullt të rasteve në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet e Republikës. Elementet e Pesë Qëllimeve të përcaktuara në këtë Plan Strategjik janë thelbësore për të fituar dhe ndërtuar besimin e publikut në këtë shtyllë jetike të pushtetit gjyqësor.

Progresi drejt arritjes së pesë qëllimeve të ndërlidhura të këtij Plani Strategjik përfundimisht do të çojë në ndërtimin e besimit dhe kënaqshmërisë së publikut në gjyqësor, i cili është jetik për të siguruar gjyqësorin si institucion i fuqishëm, i pavarur dhe i respektuar shumë.

OBJEKTIVAT STRATEGJIKE:

4.1 Të nxitet vetëdijesimi publik dhe të kuptuarit e rolit dhe funksioneve të gjyqësorit. Theksimi i transparencës së gjyqësorit si vlerë prioritare në ndërtimin e besimit dhe kënaqshmërisë së publikut.

4.2 Zbatimi i Strategjisë së Komunikimit në lidhje me aspektet e angazhimit të publikut dhe kontaktit me median, shoqërinë civile, shkollat në të gjitha nivelet, duke përfshirë fakultetet juridike, Odën e avokatëve etj.

4.3 Të theksohet rëndësia e konsistencës në arsyetime dhe vendimmarrje gjyqësore (siç është përcaktuar në Objektivin Strategjik 2.4 më lartë).

4.4 Krijimi dhe mirëmbajtja e një pyetësi në portalin e KGJK-së për t'u mundësuar qytetarëve të shprehin nivelin e tyre të kënaqësisë me gjyqësorin. Raportet mbi rezultatet e pyetësorit duhet të bëhen rregullisht dhe më pas të bëhen publike.

5 QËLLIMI 5: TEKNOLOGJIA NË MBËSHTETJE TË FUNKSIONIMIT DHE QASJES NË GJYKATA

Zhvillimi i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) ka ndikuar shumë në mënyrën se si KGJK si institucion dhe gjyqësori në përgjithësi menaxhohen dhe funksionojnë. KGJK i ka të qarta përparësitë dhe efikasitetin që teknologjia ofron për shumë aspekte të operacioneve gjyqësore, duke përfshirë menaxhimin e lëndëve, arkivimin, burimet njerëzore dhe lehtësimin e ndërveprimeve në distancë me palët e gjykatave si dhe me njësitë e tjera të pushtetit.

Rrjedhimisht, KGJK pranon se përparimet në TIK ofrojnë mundësi për të rritur efikasitetin në shumë aspekte të menaxhimit të rasteve dhe funksioneve tjera gjyqësore. Kjo ka ndikim të konsiderueshëm në elementët kyçe të Qëllimit 1 të këtij Plani Strategjik, veçanërisht pasi lidhet me efikasitetin e përgjithshëm të gjykatës. Trajnimi i personelit, monitorimi i përdorimit të proceseve të TIK-ut dhe arritja e sigurisë dhe integritetit të sistemit do të jenë thelbësore për arritjen e efikasitetit.

OBJEKTIVAT STRATEGJIKE:

5.1 Zhvillimi, avancimi dhe mirëmbajtja e një sistemi plotësisht funksional të TIK për Menaxhimin e Rasteve dhe Evidencën Penale, si dhe zgjerimin e ndërlidhjes së sistemit për menaxhimin e rasteve në gjykatë me sistemet e tjera në sektorin e sundimit të ligjit.



5.2 Sigurimi dhe integrimi i sistemeve audio dhe video në proceset gjyqësore.

5.3 Rritja e sigurisë për sistemet dhe të dhënat elektronike të gjykatës.

5.4 Rritja e kapaciteteve të stafit të TIK-ut në menaxhimin dhe funksionimin e TIK-ut.

5.5 Ofrimi i shërbimeve të caktuara virtuale për palët në gjykatë.

PLANI VJETOR I PUNËS – 2023



PLANI I PUNËS

2023



PLAN I PUNËS SË KËSHILLIT GJYËSOR TË KOSOVËS - 2023

PLANI I PUNËS 2023

Ky plan i punës është hartuar në pajtim me pesë qëllimet strategjike të Planit Strategjik të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për viti 2023-2025 dhe dokumenteve tjera strategjike të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Përveç kësaj disa nga veprimet e parashikuara në këtë plan reflektojnë rekomandimet nga Procesi i Rishikimit FunkSIONAL të Sundimit të Ligjit në Kosovë, Raporti i Vendit për vitin 2022 dhe rekomandime tjera të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare të cilat monitorojnë punën e gjyqësorit.

Përveç aktiviteteve të paraqitura në këtë plan, SKGJK dhe njësitë e tjera të KGJK-së, do t'i kryejnë veprimet dhe aktivitetet tjera të nevojshme në baza ditore, ashtu siç është përcaktuar në planet e komisioneve dhe njësive organizative brenda KGJK-së të cilat janë pjesë integrale të këtij plani.

Ky plan do të zbatohet gjatë vitit 2023, megjithatë varësisht nga nevojat dhe prioritetet e reja që mund të shfaqen, Këshilli mund ta rishkojë dhe plotësojë të njëjtin.

Për zbatimin e këtij plani njësitë dhe komisionet brenda KGJK-së, do të bashkëpunojnë dhe koordinohen në vazhdimësi, me qëllim të ngritjes së efikasitetit.

PLAN I PUNËS SË KËSHILLIT GJYËSOR TË KOSOVËS - 2023

TABELA E SHKURTESAVE

KGJK	– Këshilli Gjyqësor i Kosovës
SKGJK	– Sekretariati Këshillit Gjyqësor të Kosovës
AD	– Akademia e Drejtësisë
KAGJ	– Komisioni për Administrimin e Gjykatave
KÇN	– Komisioni për Çështje Normative
KVPGJ	– Komisioni për Vlerësimin e Performancës
KBF	– Komisioni për Buxhet dhe Financa
KT	– Komisioni për Trajnime
DAPP	– Departamenti i Administratës së Përgjithshme dhe Personelit
DBF	– Departamenti për Buxhet dhe Financa
DLO	– Departamenti për Logjistikë
DL	– Departamenti Ligjor i Këshillit
DS	– Departamenti i Statistikave
ZP	– Zyra e Prokurimit
ZKP	– Zyra për Komunikim me Publik
ZTIK	– Zyra për Teknologji Informative
NjIGJ	– Njësi për Inspektim Gjyqësor
SQEPK	- Sistemi Qendror për Evidencën Penale
NCCR	- Qendra Kombëtare për Evidencën Penale
BE	- Bashkimi Evropian
CEPEJ	- Komisioni Evropian për efikasitet në drejtësi
SMIL	- Sistemi Informativ për Menaxhimin e Lëndëve
KPK	- Këshilli Prokurorial i Kosovës
MFK	- Fondacioni Mijëvjeçar i Kosovës

PLAN I PUNËS SË KËSHILLIT GJYËSOR TË KOSOVËS - 2023

TM - Tre mujori

PLAN I PUNËS SË KËSHILLIT GJYËSOR TË KOSOVËS - 2023

VEPRIMET	KOHA E REALIZIMIT	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	TREGUESI I MATËS	NDERLIDHJA ME DOKUMNETET TJERA
Shtylla Strategjike 1 – Gjyqësori i pavarur, efikas dhe transparent				
I.Miratimi i planëve vjetore të punës së gjykatave si dhe KGJK-së	TM1	KGJK Gjykatat	Plani vjetor i miratuar dhe i zbatuar	Plani Strategjik i KGJK-së 2023-25 Ligji për Gjykatat
II. Zbatimi i Strategjisë për Përmirësimin e Qasjes në Drejtësi	Vazhdimësi	KGJK Gjykatat Komisioni për Monitorimin e Implementimit të Strategjisë Justice Activity-USAID	Raportimi tre mujor i kryetarëve të gjykatave Raportimi i Komisionit	Strategjia për Përmirësimin e Qasjes në Drejtësi
III. Zbatimi i Planit Strategjik për zgjidhjen efikase të lëndëve të korrupsionit dhe krimit të organizuar 2022-2024	Vazhdimësi	KGJK Gjykatat Komisioni për Monitorimin e Implementimin e Strategjisë	Raportimi tre mujor i kryetarëve të gjykatave Raportimi i Koordinatorit Raportimi i Komisionit	Plani Strategjik për zgjidhjen efikase të lëndëve të korrupsionit dhe krimit të organizuar 2022-2024

PLAN I PUNËS SË KËSHILLIT GJYËSOR TË KOSOVËS - 2023

IV. Qëndrueshmëria e Sistemit të evidencës penale	TM2	Gjykatat KGJK- Njësia për Evidencën Penale NCCR	Sistemi i Evidencës Penale i zbatueshëm	Strategjia për Sundimin e Ligjit dhe Plani i Veprimit të Strategjisë Legjisclacioni në fuqi
V. Adresimi dhe zbatimi i rekomandimeve të dalura nga vlerësimet e institucioneve ndërkombëtare që monitorojnë sistemin gjyqësor	Vazhdimësi	KGJK Gjykatat Zyra për Integritet Evropian	Raportimet tre mujore mbi zbatimin e rekomandimeve	Raporti i vendit Programi kombëtar për zbatimin e PKZMSA Agjenda për Reformë Evropiane Nën-komiteti për Drejtësi, Liri dhe Siguri Programi për Reform në Ekonomi Si dhe institucione tjera
VI. Monitorimi i respektimit të afateve për ekzekutimin në kohë të vendimeve gjyqësore të formës së prerë	Vazhdimësi	Kryetarët e gjykatave	Raportimet tre mujore nga kryetarët e gjykatave	Strategjia për Përmirësimin e Qasjes në Drejtësi Legjisclacionin në fuqi
VII. Publikimi i aktgjyqimeve dhe aktvendimeve	Vazhdimësi	Kryetarët e gjykatave	Aktgjykimet dhe aktvendimet e publikuara	Strategjia për Sundimin e Ligjit dhe Plani i Veprimit të Strategjisë Legjisclacionin në fuqi
VIII. Respektimi i afatave lidhur me dërgimin e lëndëve në gjykatën e shkallës së dytë dhe tretë.	Vazhdimësi	Gjykatat	Aktet gjyqësore të dërguara me kohë sipas mjetit juridik	Strategjia e Sundimit të Ligjit dhe Plani i Veprimit të Strategjisë Legjisclacioni në fuqi

PLAN I PUNËS SË KËSHILLIT GJYËSOR TË KOSOVËS - 2023

Shtylla Strategjike 2- Cilësia, llogaridhënia dhe profesionalizmi i gjyqësorit

I. Vlerësimi i performancës së gjyqtarëve sipas shortit, ngritjes në detyrë dhe mandat fillestar.	Vazhdimësi	Komisioni për Vlerësimin e Performancës së gjyqtarëve KGJK	Vlerësimi i përfunduar	Strategjia për Sundimin e Ligjit dhe Plani i Veprimit të Strategjisë Legjislacioni në fuqi
II. Miratimi dhe zbatimi i Rregullorës për Vlerësimin e performancës së Kryesudit, Zëvendës Kryesudit dhe anëtarëve të KGJK-së, kryetarëve të gjykatave dhe gjyqtarëve mbikëqyrës	Vazhdimësi	Komisioni ad-hoc KGJK në raport me gjyqtarët Kryetarët e gjykatave në raport me gjyqtarët mbikëqyrës	Vlerësimi i përfunduar	Strategjia për Sundimin e Ligjit dhe Plani i Veprimit të Strategjisë Legjislacioni në fuqi
III. Funksionalizimi i dosjes elektronike të gjyqtarëve	TM4	KGJK EUKOJUST	Dosja elektronike funksionale	
IV. Identifikimi i nevojave për trajnim të gjyqtarëve dhe zbatimi i planit të trajnimeve	TM1	KGJK Akademia e Drejtësisë	Plani i trajnimeve i hartuar dhe zbatuar	Strategjia për Sundimin e Ligjit dhe Plani i Veprimit të Strategjisë

PLAN I PUNËS SË KËSHILLIT GJYËSOR TË KOSOVËS - 2023

V. Programi i trajnimeve për administratën	TM1	KGJK Gjykatat Akademia e Drejtësisë	Programi i trajnimeve për vitin 2023 i miratuar dhe zbatuar	Strategjia për Sundimin e Ligjit dhe Plani i Veprimit të Strategjisë
VI. Plani i trajnimeve për gjyqtarët porotë	TM1	KGJK Gjykatat Akademia e Drejtësisë	Plani i miratuar dhe zbatuar	Legjislacioni në fuqi
VII. Përmirësimi i menaxhimit të dosjes në mënyrë fizike	Vazhdimësi	Kryetarët e gjykatave	Raportimet tre mujore të kryetarëve	
VIII. Vlerësimi vjetor i punës së stafit menaxhues, profesional (bashkëpunëtorve profesional) dhe stafit administrativ	TM4	Kryetarët e gjykatave Gjyqtarët mbikëqyrës Gjyqtarët Administratorët/Ndihmës Administratorët SKGJK	Vlerësimet e realizuara Nevoja për trajnim të identifikuar	
IX. Mbikëqyrja dhe përmirësimi i shërbimit për shpërndarjen e shkresave përkatësisht postës, duke evituar mundësinë e dështimit të seancave për shkak të shpërndarjes	Vazhdimësi	KGJK- SKGJK Kryetarët e gjykatave Administratorët	Zbatimi i kontratës nga Posta e Kosovës Zbatimi i Udhëzuesit të KGJK-së për procedurën e dërgimit të shkresave nga gjykatat	Legjislacioni në fuqi

PLAN I PUNËS SË KËSHILLIT GJYËSOR TË KOSOVËS - 2023

X. Zbatimi i Opinioneve të Komitetit Këshilldhënës për Etikë gjyqësore	Vazhdimësi	KGJK Gjykatat	Opinionet e zbatuara	Strategjia për Sundimin e Ligjit dhe Plani i Veprimit të Strategjisë
XI. Publikimi i vendimeve disiplinore ndaj gjyqtarëve	Vazhdimësi	KGJK	Vendimet e publikuara	Strategjia për Sundimin e Ligjit dhe Plani i Veprimit të Strategjisë
XII. Rekrutimi i gjyqtarëve, stafit menaxhues, bashkëpunëtorve profesional si dhe stafit administrativ në bazë të parimit të meritokracisë dhe transparencës	Vazhdimësi	KGJK SKGJK	Plani vjetor për rekrutim i miratuar dhe i buxhetuar Rekrutimet e përfunduara	Strategjia për Sundimin e Ligjit dhe Plani i Veprimit të Strategjisë
XIII. Plani për zbatimin e rekomandimeve të Zyrës Kombëtare për Auditim	30 ditë pas pranimit të Raportit final	KGJK Gjykatat	Plani i hartuar dhe zbatuar	
XIV. Përgatitja e KASH dhe planit vjetor të buxhetit	Vazhdimësi	KGJK SKGJK Komisioni për Buxhet dhe Financa	Propozimet e KASH Plani vjetore të realizuara	Strategjia për Sundimin e Ligjit dhe Plani i Veprimit të Strategjisë
Shtylla Strategjike 3: Qasja në drejtësi				
I. Promovimi dhe monitorimi i zbatimit të Udhëzuesit për Politika Ndëshkimore për të siguruar shkallë më të lartë të uniformitetit në shqiptimin e dënimeve nga gjykatat	Vazhdimësi	KGJK Gjykatat	Raportimi nga Komisioni	Strategjia për Sundimin e Ligjit dhe Plani i Veprimit të Strategjisë

PLAN I PUNËS SË KËSHILLIT GJYËSOR TË KOSOVËS - 2023

II. Rritja e shfrytëzimit të ndërmjetësimit si mjet alternativ për zgjidhjen e lëndëve	Vazhdimësi	Gjykatat Partnerët ndërkombëtar	Rritja e numrit të rasteve të referuara dhe të zgjidhura në procedurën e ndërmjetësimit	Strategjia për Sundimin e Ligjit dhe Plani i Veprimit të Strategjisë Legjislacioni në fuqi
III. Rishikimi dhe avancimi i formave standarde të aktgjykimeve dhe vendimeve gjyqësore	TM2	KGJK Gjykatat Justice Activity USAID	Format e miratuara dhe zbatuara nga të gjitha gjykatat	Strategjia për Sundimin e Ligjit dhe Plani i Veprimit të Strategjisë Legjislacioni në fuqi
IV. Planifikimi dhe zhvillimi i infrastrukturës përfshirë ndërtimin e objekteve të reja të gjykatave, renovimin, sigurinë dhe mirëmbajtjen e tyre	Vazhdimësi	KGJK Gjykatat	Plani i miratuar dhe buxhetuar	
V. Zbatimi i projektit të audio dhe video incizimit për gjykata,	Vazhdimësi	KGJK Gjykatat Ambasada e SHBA- INL	Projekti i zbatuar	
VI. Gjenerimi dhe azhurnimi i të dhënave statistikore	Vazhdimësi	KGJK NJIGJ Gjykatat	Raportet statistikore të realizuara	Strategjia për Sundimin e Ligjit dhe Plani i Veprimit të Strategjisë Standardet e CEPEJ

PLAN I PUNËS SË KËSHILLIT GJYËSOR TË KOSOVËS - 2023

VII. Përgatitja dhe publikimi i materialeve informuese dhe kampanjave online për udhëzimin e qytetarëve për aktivitetet gjyqësore që zhvillohen në gjykatë	Vazhdimësi	KGJK Gjykatat Partnerët ndërkombëtar	Materialet informuese të publikuara	Strategjia për Sundimin e Ligjit dhe Plani i Veprimit të Strategjisë
Shtylla Strategjike 4: Besimi dhe kënaqshmëria e publikut				
I. Zbatimi i Strategjisë për Komunikim të Këshillit Gjyqësor të Kosovës 2022-2024	Vazhdimësi	KGJK Gjykatat Justice Activity USAID	Raportet e publikuara për zbatimin e strategjisë Komunikimi i përmirësuar	Strategjia për Komunikim të Këshillit Gjyqësor të Kosovës 2022-2024
II. Publikimi i aktgjyqimeve dhe aktvendimeve	Vazhdimësi	Gjykatat	Aktgjykimet dhe aktvendimet e publikuara	Legjislacioni në fuqi

PLAN I PUNËS SË KËSHILLIT GJYËSOR TË KOSOVËS - 2023

III. Qasja e publikut përmes transmetimit të drejtpërdrejt të takimeve të KGJK-së, Asamblesë së kryetarëve dhe gjyqtarëve mbikëqyrës, si dhe takimeve të KGJK-së me kryetarët	Vazhdimësi	KGJK	Takimet e transmetuara drejtpërdrejt	Strategjia për Sundimin e Ligjit dhe Plani i Veprimit të Strategjisë
IV. Azhurnimi i vazhdueshëm i web faqës zyrtare të KGJK-së dhe gjykatave	Vazhdimësi	KGJK Gjykatat	Të dhënat e azhurnuara	Strategjia për Komunikim të Këshillit Gjyqësor të Kosovës 2022-2024
V. Publikimi i vendimeve të panelit për Lirim me Kusht sipas legjislacionit në fuqi	Vazhdimësi	KGJK Paneli për Lirim me Kusht	Vendimet e publikuara me kohë	Strategjia për Sundimin e Ligjit dhe Plani i Veprimit të Strategjisë
VI. Publikimi i listës me të dhënat e kompensimeve të personave të privuar nga liria padrejtësisht	Vazhdimësi	KGJK Komisioni për Kompensim	Listat e publikuara	Strategjia për Sundimin e Ligjit dhe Plani i Veprimit të Strategjisë
VII. Zhvillimi i aktiviteteve të përbashkëta për avancimin e raporteve ndërmjet gjyqësorit me media, shoqërinë civile dhe publikun	Vazhdimësi	KGJK Gjykatat Justice Activity USAID	Takimet dhe aktivitetet e realizuara Nënshkrimi i marrëveshjeve për bashkëpunim	Strategjia për Sundimin e Ligjit dhe Plani i Veprimit të Strategjisë Strategjia për Komunikim të Këshillit Gjyqësor të Kosovës 2022-2024
Shtylla Strategjike 5: Teknologjia në mbështetje të funksionimit dhe qasjes në drejtësi				
I. Hartimi dhe miratimi i Strategjisë së TIK për gjyqësor	Q4	KGJK Gjykatat Partnerët Ndërkombëtar	Strategjia e miratuar	

PLAN I PUNËS SË KËSHILLIT GJYËSOR TË KOSOVËS - 2023

II. Ofrimi i shërbimeve online për pagesat e taksave gjyqësore	Q2	KGJK Gjykatat Partneret Ndërkombëtar	Funksionalizimi i plotë i sistemit	Strategjia për Sundimin e Ligjit dhe Plani i Veprimit të Strategjisë
III. Dërgimi i ftesave online palëve për seancat gjyqësore	Q4	KGJK Gjykatat Partneret Ndërkombëtar	Funksionalizimi i plotë i sistemit	Strategjia për Sundimin e Ligjit dhe Plani i Veprimit të Strategjisë
IV. Përditësimi i politikave dhe procedurave të TIK për departamentin e IT	Q4	KGJK Partnerët Ndërkombëtar	Aktet e miratuara	
V. Monitorimi dhe mbikëqyrja e përdorimit të SMIL dhe NCCR, për të siguruar përdorimin e plotë dhe cilësinë e të dhënave	Vazhdimësi	KGJK	Monitorimi i përfunduar	
VI. Rritja e ndërgjegjësimit për sigurinë kibernetike	Vazhdimësi	KGJK Gjykatat Partnerët Ndërkombëtar	Aktivitetet e përfunduara	
VII. Zbatimi i SMIL në të gjitha procedurat e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore	Vazhdimësi	KGJK	Zbatimi i SMIL	



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KOMISIONI PËR ÇËSHTJE NORMATIVE

KOMISIONI PËR ÇËSHTJE NORMATIVE – DRAFT PLANI I PUNËS PËR 2023

Objektiva:	Veprimi/Aktivitetet:	Afatet:	Institucioni/Stafi përgjegjës:	Bashkëpunimi me partnerët lokal dhe ndërkombëtar:	Implikimet buxhetore:	Komentet dhe Miratimi
Forcimi i llogaridhënies së punës gjyqtarëve	1. Rishikimi i Rregullores për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve	TREM III	KÇN SKGJK NJIGJ Departamenti për Çështje Ligjore Kryetari i Komisionit për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve			Mungon drafti fillestar

Zbatimi i Ligjit për Këshillin Gjyqësor	2.Hartimi I Rregullores për Vlerësimin e Performancës Së Kryesuesit, Zëvendës Kryesuesit dhe Anëtarëve Me Orar Të Plotë Të Këshillit Gjyqësor Të Kosovës	TM II	KÇN NJIGJ Departamenti për Çështje Ligjore			Draft rregullorja është hartuar, e ka konsumuar fazën e konsultimit publik
	3.Hartimi i rregullores për procedurën e avancimit të gjyqtarëve	TM III	KÇN NJIGJ Departamenti për Çështje Ligjore		Siç parashihet me buxhetin e miratuar për Këshillin Gjyqësor të Kosovës	Draft rregullorja është hartuar
Forcimi i llogaridhënies së Kryetarëve	4. Rregullore për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores 06/2017 për trajnimin e Gjyqtareve ne lidhje me trajnimin e Kodit te Etikes	TM IV	KÇN Komisioni për Trajnime Departamenti për Çështje Ligjore			
Forcimi i efikasitetit ne gjyqësor	5. Hartimi i rregullores për përdorimin e SMIL	TM II	KÇN Departamenti për Çështje Ligjore DIT	-	Siç parashihet me buxhetin e miratuar për Këshillin Gjyqësor të Kosovës;	Rreg eshte e parapare per PKZMSA 2023 ne kuartalin II

Përmirësimi i transparencës së Këshillit	6. Rregullore për klasifikim të dokumenteve	TM IV	KÇN Departamenti për Çështje Ligjore Zyra për Përkthime			Me qëllim të zbatimit të rekomandimeve të Rishikimit Funkcional dhe zbatimit të Strategjisë së Këshillit Gjyqësor të Kosovës, KÇN do të hartojë rregullore për Përmirësimin e transparencës së Këshillit.
	7. Rregullore për Qasje ne Dokumente Publike	TM III				Drafti është hartuar, është ne konsultim publik
Forcimi i efikasitetit ne gjyqësor	8. Kodi i etikës për punën e përkthyesve dhe interpreteve ne sistemin gjyqësor të Kosovës	TM IV				Drafti është i hartuar
	9. Hartimi i Doracakut për punën e përkthyesve dhe interpretove në sistemin gjyqësor të Kosovës	TM IV			ZP, EUKOJUST	Drafti është i hartuar
